

## Abonimi „Scool“ VVS

Për udhëtimin për në shkollën tonë këshillohet pjesmarrja në abonimin „Scool“ të kompanisë Verkehrs- und Tarifverbund Stuttgart (VVS). Për një **pjesmarrje me kosto prej 43,20 €** përkatësisht 40,20 € në Stuttgart (Informacioni tarifor 1.1.2018) mund të udhëtohet nga vendbanimi për në shkollë dhe në kohën e lirë në të gjithë rrjetin e VVS-së, me të gjithë autobusat dhe trenat. Në disa raste ka devijime nga rregulloret e qarqeve.

### Vështrim i përgjithshëm mbi avantazhet e abonimit Scool

- I vlefshëm në të gjithë rrjetin „në çdo kohë“ pa kosto suplementare
- **Muaji gusht i pushimeve gratis pa tërheqje**
- **Shpërndarje si biletë eTicket-Chipkarte polygon** me përparësi të shumta: <https://www.my-polygo.de/>.
- Dërgim pa problem në shtëpi i kartës me çip.
- Në rast humbjeje/dëmtimi i eTicket-Chipkarte-s lëshohet një zëvendësues kundrejt pagesës së taksës për punën prej 15,00 € (Informacioni tarifor 1.1.2018).

### Sqarime dhe takime

#### Pjesmarrja në abonim

Letërporosia për pjesmarrjen në abonimin Scool duhet dorëzuar në shkollë jo më vonë se fundi i korrikut. Karta me çip do të dërgohet direkt në shtëpi. Tërheqja e abonimit bëhet çdo herë në fillim të muajit.

#### Mosshfrytëzimi i muajve të veçantë

Abonimi Scool vlen parimisht për kohëzgjatjen e të gjithë vitit shkollor (shtator deri në gusht të vitit të ardhshëm). Në rast se nuk do të udhëtohet një muaj, atëherë duhet që deri më 1. të muajit paraprak të njoftohet për këtë qendra përkatëse e abonimit me shkrim apo në formë elektronike. Kështu në muajin në vazhdim nuk do të bëhet tërheqje dhe karta me çip do të bllokohet në mënyrë elektronike.

#### Tërheqja pa sukses

Në rastin e një tërheqjeje pa sukses të pjesës vetjake së koston atëherë fillon një procedurë paralajmëruese, për të cilën do të paguhet taksa për punën e saj në masën prej 3,50 €, si edhe taksa suplementare të huaja (psh. taksat e bankës). Paguesit e çrregullt do të përjashtohen nga procedura e abonimit VVS konform ligjit tarifor të procedurës së abonimit „Scool“ të VVS-së dhe karta me çip do të bllokohet. Veç kësaj për zëvendësim duhet që në të ardhmen të sigurohen pulla me vlerë në njërin prej pikave të shitjes.

#### Zgjatjet

Në rast se në vitin e ardhshëm do të vazhdojë të frekuentohet shkolla, atëherë abonimi zgjatet automatikisht.

#### Regjistrime të mëvonshme

Në rast se nuk mund të respektohet afati i dorëzimit për në fund të korrikut, atëherë duhet vepruar si më poshtë, me qëllim për të patur mundësi për përdorim të mjeteve të qarkullimit publik: Në shtator lëshohet nga shkolla një dëshmi zëvendësuese përkatëse, me të cilën mund të blihet aboneja mujore për nxënës për muajt shtator dhe tetor, dhe eventualisht edhe pulla me vlerë zëvendësuese me çmim të plotë (lidhur me kthimin mbrapsh të shpenzimeve për pjesën vetjake shih procedurën për kthimin mbrapsh). Pjesmarrja në procedurën e abonimit „Scool“ është i mundur duke filluar nga nëntori. Për këtë duhet që letërporosia „Scool“ duhet të dorëzohet në sekretarinë e shkollës jo më vonë se fundi i javës së parë të shkollës. Më tej dërgimi i kartës me çip pason brënda afatit deri në fund të tetorit.

#### Procedura për kthimin mbrapsh

Gjithësecili që nuk ka dëshirë të marrë pjesë në procedurën e abonimit „Scool“ të VVS-së, shënon në fletëporosinë „**Vetëm porosi e dëshmisë përkatëse**“, e vërteton këtë nga shkolla dhe merr në njërin nga pikat e shitjes pullat mujore me vlerë për nxënës. Fillimisht çmimi i blerjes paguhet tërësisht. Në fund të simestrit të parë përmes shkollës bëhet kërkesa për kthimin mbrapsh të atyre shpenzimeve, të cialt e tejkalojnë pjesën vetjake mujore. Pra shërbimit nga abonimi Sool (psh pullat me vlerë suplementare gratis për rrjetin, rregullimet zëvendësuese në rast humbjeje) për fat të keq nuk mund të sigurohen.

**Informacione të tjera ndodhen në shërbimet telefonike të VVS-së në numrin 0711 / 19449**